



Data: 18.05.2018

Ref.: 457/18D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 55-të, të mbajtur më 10 Maj 2018, mori:

## V E N D I M

- I. Zgjatet periudha e akreditimit institucional të “Kosovo Art Academy” për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2018 – 30 shtator 2019.
- II. Zgjatet periudha e akreditimit për programet e studimit të “Kosovo Art Academy”, të cekura me poshtë për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2018 – 30 shtator 2019:
  - Fotografi, BA, 180 ECTS;
  - Grafik Dizajn & Multimedial, BA, 180 ECTS;
  - Dizajn, BA, 180 ECTS.
- III. Kuotat për regjistrimin e studentëve në programet respektive, vlejné sipas vendimit të fundit të KSHC-së për ri/akreditimin të programeve studimore përkatëse.

## Arsyetimi

I. Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 10 Maj 2018 mori vendim për zgjatjen e periudhës së akreditimit institucional dhe të programeve të studimit për BPrAL “Kosovo Art Academy”, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin I dhe II, të këtij vendimi. Duke pasur parasysh se dinamika e AKA-së për vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë është ndërprerë për 7 muaj dhe se procesi i vlerësimit të jashtëm nuk është organizuar, vizita me ekspertë ndërkombëtar nuk është realizuar sipas afateve të parapara nga AKA, dhe rrjedhimisht rrezikohet vonimi i regjistrimit të studentëve të rinj në këto programe të studimit, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Bazuar në nenin 15, pika 3 e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe dispozitave të tjera ligjore të cekura më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.04/L-037-datë: 29.08.2011, neni 15, Pika 3, i cili përcakton se “Riakreditimi i bartësve kryhet nga AKA-ja në intervale kohe prej jo më shumë se 5 vjetësh. Riakreditimi nuk bëhet pa një shqyrtim të raportit të vetëvlerësimit të bartësit, nga ana e ekspertëve, përveç në rrethana të veçanta. Ky rishikim nga ana e ekspertëve do të përfshijë një inspektim të drejtpërdrejtë të ofrimit të shërbimeve. Riakreditimin e një institucioni apo të një

1/2

ose më shumë programeve të tij mund ta kërkojnë bordi i AKA-së ose Ministria brenda një periudhe më të shkurtër se pesë vjet.”, si dhe dispozitave të tjera ligjore të cekura më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në përputhje me legjislacionin në fuqi do të monitorojë në vazhdimësi BPrAL-në “Kosovo Art Academy” me qëllim që të sigurojë se kriteret minimale të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e IAL-ve në Kosovë (Nr.9/2017, datë 02.08.2017) plotësohen në vazhdimësi për paragrafin I, II, III të këtij vendimi. Në të kundërtën KSHC i AKA-së rezervon të drejtën që në njërin nga mbledhjet e radhës së KSHC-së të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi pasi të ketë konstatuar se ky institucion nuk ka arritur të sigurojë përmbushjen e kriteve minimale të përcaktuara në këtë UA Nr.9/2017, datë 02.08.2017.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencisë së Kosovës për Akreditim siç përcaktohet në nenin 128 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 02/L-28, në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL, “Kosovo Art Academy”
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

